Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve te Aplikuara**		
Titulli i lëndës:	**Vizatim I**		
Niveli:	**Bachelor**		
Statusi lëndës:	**Obligative**		
Viti i studimeve:	**1**		
Numri i orëve në javë:	**3**		
Vlera në kredi – ECTS:	**6**		
Përshkrimi i lëndës	Lënda **Vizatim I** i pajis studentët me njohuritë dhe aftësitë bazë në vizatim, duke u përqendruar në elementet themelore si vija, forma, tekstura, hapësira dhe dritë-hija, si dhe në parimet kryesore të kompozicionit, përfshirë ekuilibrin, ritmin, kontrastin dhe harmoninë vizuale. Përmes kombinimit të teorisë me punën praktike, studentët zhvillojnë aftësitë e vëzhgimit dhe analizës së formës, duke zbatuar teknika të ndryshme për realizimin e vizatimeve të strukturuara dhe të balancuara. Studentët përdorin materiale dhe teknika të ndryshme, si lapsi, qymyri dhe tushi, duke zhvilluar aftësitë teknike dhe shprehëse në realizimin e punimeve të tyre.		
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi i lëndës është t'i pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë bazë në vizatim, duke zhvilluar kuptimin e elementeve dhe parimeve themelore si linja, forma, tekstura, hapësira, dritë-hija, proporcioni, perspektiva dhe kompozicioni. Përmes punës praktike studentët zhvillojnë aftësinë e vëzhgimit, analizës dhe shprehjes vizuale duke përdorur mjete dhe teknika të ndryshme të vizatimit.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të modulit, studenti do të jetë në gjendje të: • Njohë dhe përdorë mjetet dhe teknikat bazë të vizatimit. • Kuptojë dhe zbatojë proporcionet dhe perspektivën në vizatim. • Aplikojë parimet e kompozicionit për të krijuar vizatime të balancuara. • Analizojë dhe vizatojë modele me saktësi dhe detaje. • Përdorë linjën, formën, teksturën dhe dritë-hijen për të paraqitur formën dhe hapësirën.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	1	15	15

Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	3	14	42
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	6	12
Ushtrime në teren	3	3	9
Kollokfiume, seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	3	5	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	3	1	3
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	3
Projektet, prezentimet, etj	2	3	6
Totali			**150**
Metodologjia e mësimëdhënies:	Mësimdhënia realizohet përmes ligjëratave interaktive, demonstrimeve praktike dhe analizës së shembujve vizualë. Studentët zhvillojnë ushtrime individuale dhe grupore, punë praktike dhe studime nga modele të ndryshme. Procesi mësimor përfshin gjithashtu prezantimin, kritikën dhe analizën e punimeve, konsultimet me mësimdhënësin, si dhe vizita në galeri, muze dhe ekspozita.		
Metodat e vlerësimit:	70% Punime praktike 10% Prezantim 20% Provim final		
Literatura			
Literatura bazë:	Drawing for the Absolute Beginner: A Clear & Easy Guide to Successful Drawing Book by Mark Willenbrink		
Literatura shtesë:	Drawing on the Right Side of the Brain: The Definitive, 4th Edition Paperback – April 26, 2012 by Betty Edwards		

Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**
Java e parë:	• **Hyrje në Vizatim dhe Historiku i Vizatimit** *Njohja me historinë e vizatimit, prezantimi i lëndës dhe rëndësia e saj në art dhe dizajn.*
Java e dytë:	• **Njohja me Teknikat e Vizatimit dhe Mjetet e punës**

	Prezantimi i teknikave bazike të vizatimit dhe njohja me mjetet kryesore (lapsat, qymyr,tush, stilolaps etj.). Demonstrim i përdorimit të tyre. Vizatim shprehje e lirë me vija
Java e tretë:	• **Linja dhe Forma** *Studimi i linjës si element bazik dhe roli i saj në krijimin e formave. Vizatimi i formave gjeometrike dhe natyrale.*
***Java e katërt*:**	• **Proporcionet dhe Matjet në Vizatimin e Modeleve** *Njohja me raportet proporcionale në vizatim. Si të maten proporcionet e sakta të një objekti duke përdorur lapsin si njësi matëse.*
Java e pestë:	• **Natyra e Qetë (Still Life):** *Elementet bazë* *Vizatimi i objekteve të përditshme nga natyra e qetë. Zhvillimi i aftësive të vëzhgimit dhe kuptimi i formës dhe përbërjes së objekteve.*
Java e gjashtë:	• **Drita dhe Hija në Vizatim: Tonet dhe Tekstura** *Kuptimi i burimit të dritës dhe ndikimi i tij në hijet dhe tonet. Përdorimi i hijeve për të krijuar thellësi dhe për të theksuar formën.*
Java e shtatë:	• **Portreti: Amfaz (Pamje ballore)** *Studimi i formave dhe proporcionet e fytyrës njerëzore në pamje ballore (amfaz).*
Java e tetë:	• **Portreti: Profil (Pamje anësore e portretit)** *Vazhdim i studimit të portretit, kësaj here duke u fokusuar në profil.*
Java e nëntë:	**Perspektiva dhe paraqitja e hapësirës –** *konceptet bazë, vija e horizontit, pika e zhdukjess dhe llojet e perspektivës*
Java e dhjetë:	**Perspektiva lineare – një dhe dy pika –** *ushtrime praktike me objekte, hapësira dhe forma të thjeshta*
***Java e njëmbedhjetë*:**	**Kompozicioni në vizatim** *Organizimi i elementeve në hapësirë; ekuilibri, ritmi, kontrasti, fokusi dhe raporti figurë–sfond.*
***Java e dymbëdhjetë*:**	**Vizatimi nga vëzhgimi: objekte dhe forma natyrore** *Studimi i formës, proporcionit, strukturës, teksturës dhe detajeve përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë.*
***Java e trembëdhjetë*:**	• **Temë e Lirë e zgjedhur nga studentët** *Studentët janë të lirë të zgjedhin një temë sipas interesave të tyre personale për të krijuar një vepër artistike që pasqyron stilin, emocionet dhe krijimtarinë e tyre.*
***Java e katërmbëdhjetë*:**	• **Vizatimi Digjital: Hyrje dhe Mjetet e Vizualizimit**

	Përdorimi i softuerëve bazë për vizatimin dixhital si Photoshop, Illustrtor etj. *Studentët do të zhvillojnë aftësi për të krijuar punime të plota artistike, duke filluar nga skicimi deri te finalizimi, në format tradicional (letër) ose në format digjitale, duke eksploruar avantazhet dhe veçoritë e secilit medium.*
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	**Ushtrime dhe analizë kritike** e punimeve nga kolegët dhe mësimdhënësi për të reflektuar mbi përparimin artistik.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Pjesëmarrja e rregullt dhe angazhimi aktiv janë të detyrueshme. Studentët duhet të sjellin materialet e tyre, të jenë të përgatitur për punë dhe të respektojnë ambientin e klasës. Kritikat ndaj punimeve të kolegëve duhet të jenë konstruktive, duke respektuar përpjekjet e të gjithëve. Origjinaliteti dhe sjellja etike janë thelbësore, ndërsa përdorimi i pajisjeve elektronike lejohet vetëm për qëllime mësimore.	